



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d) dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 13, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, nr. 06/L-092, nenit 6 paragrafët 2 dhe 3 të Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nr. 09/2020, nenit 33.2, shkronja a), dhe nenit 34.1 shkronja d) të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.12.2022, merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË VEÇANTË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHEN PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM NË VITIN 2023

1. **MIRATOHET** Lista e veçantë e pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim në vitin 2023.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, lista e pronave të paluajtshme përmban: të dhënat kadastrale, qëllimin e dhënies në shfrytëzim, destinimin, datën e publikimit të njoftimit si dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e veçantë e pronave të Komunës, të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023, përfshirë certifikatën e pronësisë, kopjen e planit, si dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm për secilën pronë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe drejtoritë e tjera relevante me të.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/06-277040/22, më 29.12.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

